



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 237/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, si dhe te subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj koalicionit AAK - PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen te pabazuar ankesat: Anr.237/2019, Anr. 270/2019, dhe Anr.302/2019, te gjitha te datës 05.10.2019, te paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, si dhe nga subjekti politik Lidhja Demokratike (LDK), me seli në Prishtinë, kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhimit të sponsorimit e fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.237/2019, Anr. 270/2019, dhe Anr.302/2019, te datës 05.10.2019 dhe 06.10.2019, te paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, si dhe nga subjekti politik LDK, të paraqitura kundër Koalicionit AAK - PSD, me të cilat kanë pretenduar, se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatët për deputet te paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen si të bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuar, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.237/2019, Anr. 270/2019, dhe Anr.302/2019, te datës 05.10.2019, dhe 06.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik.

Duke qene se janë plotësuar kushtet ligjore, Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim*”, paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse edhe pse barra e te provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për te provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruar nga ankuesit, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamat e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por qe nuk ka qenë e mundur te vërtetohet në rrugë elektronike nëse te njëjtat një ditë me parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit te njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.237/2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Ferki Xhaferi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*